



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:081786

Datë: 27.01.2023

Numri i dokumentit: 03909766

P.nr.100/22

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa , duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.2/23 të datës 23.01.2023 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit Xh.M nga fshati ..., Komuna Kaçanik dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës ...-Distrikti Ferizaj, e autorizuar, M. Sh., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.529/22 të datës 20.04.2022, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 26.01.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.2/23 të datës 23.01.2023, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit Xh.M dhe përfaqësueses të të dëmtuarës ...-Distrikti Ferizaj, M. Sh.

HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.529/22 e datës 20.04.2022, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit Xh.M nga fshati ..., Komuna Kaçanik, i lindur me datë 07.02.1973 për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.529/22 e datës 20.04.2022, e ka akuzuar të pandehurin Xh.M nga fshati .., Komuna Kaçanik për shkak të veprës penale , Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 08.09.2022, palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si P.nr.100/22, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 23.01.2023, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.2/23, në mes palëve në procedurë dhe atë të pandehurit Xh.M, nga fshati ..., Komuna Kaçanik, dhe përfaqësuesit të dëmtuarës ...-Distrikti Ferizaj, M.Sh.

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 358 par. 1 të KPP-se lidhur me nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.100/22 datë, 26.01.2023

Sekretarja juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.